Drejtuar: Komisionit Hetimor Parlamentar për veprimet dhe mosveprimet institucionale lidhur me vrasjen e Arlinda Zekajt dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe grave në familje

Nga: Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK)

Data: 17 nëntor 2026

Lënda: Kërkesë për ftesë në dëgjim, përfshirje të ekspertizës dhe monitorim të procesit hetimor

Të nderuar anëtarë të Komisionit,

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) e mirëpret themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar si një mundësi të rëndësishme për të vendosur llogaridhënie institucionale, për të identifikuar dështimet në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve dhe për të nxjerrë rekomandime konkrete që parandalojnë tragjedi të tjera në të ardhmen.

Megjithatë, zhvillimet e deritanishme ngrenë shqetësime serioze lidhur me transparencën e procesit, përfshirjen e ekspertizës së specializuar dhe konsultimin me organizatat e shoqërisë civile.

Së pari, lidhur me përfshirjen e ekspertizës në procesin hetimor: Më 11 nëntor, Komisioni përzgjodhi tre ekspertë të jashtëm për të mbështetur punën e tij. Megjithatë, deri më tani nuk kemi informata të qarta publike lidhur me rolin, fushëveprimin dhe mënyrën se si ekspertiza e tyre do të integrohet në procesin hetimor. Duke qenë se Komisioni tashmë ka përcaktuar kalendarin e dëgjimit të dëshmitarëve dhe, sipas njoftimeve publike, intervistimet pritet të fillojnë më 18 nëntor, konsiderojmë thelbësore që ekspertiza e organizatave të specializuara të shoqërisë civile të përfshihet që në këtë fazë. Një përfshirje e tillë do të kontribuonte në orientimin e pyetjeve, identifikimin e boshllëqeve procedurale dhe vlerësimin e zbatimit të kornizës ligjore dhe mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve.

Së dyti, lidhur me mungesën e konsultimit me shoqërinë civile: RrGK dhe organizatat anëtare kanë mbi 20 vjet përvojë të drejtpërdrejtë në adresimin e dhunës me bazë gjinore, përmes punës me të mbijetuarat, përfaqësimit ligjor në mbi 150 raste dhe monitorimit të mbi 470 rasteve gjyqësore. Përmes kësaj pune kemi dokumentuar dhe analizuar mangësitë në vlerësimin e rrezikut, zbatimin e masave mbrojtëse, trajtimin institucional të rasteve dhe koordinimin ndërinstitucional. Kjo përvojë përbën një burim të rëndësishëm ekspertize dhe dëshmish për punën e Komisionit. Pavarësisht gatishmërisë sonë të vazhdueshme për të kontribuar, deri më tani RrGK nuk është ftuar për konsultim apo dëgjim nga Komisioni.

Duke pasur parasysh sa më sipër, si dhe faktin se dëgjimi i dëshmitarëve pritet të fillojë më 18 nëntor, Rrjeti i Grave të Kosovës kërkon:

1. **Të ftohet zyrtarisht për dëgjim në njërën nga mbledhjet e Komisionit**, në mënyrë që të prezantojë gjetjet, dokumentacionin dhe rekomandimet e tij lidhur me dështimet institucionale në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve.
2. **T'i mundësohet RrGK-së dorëzimi zyrtar i analizave, raporteve dhe rasteve të dokumentuara për përfshirje në dosjen hetimore**, në mënyrë që ato të shqyrtohen dhe të shfrytëzohen si dëshmi dhe referencë përgjatë procesit hetimor.

3. **Të qartësohet roli dhe fushëveprimi i ekspertëve të angazhuar nga Komisioni**, si dhe të sigurohet përfshirja kuptimplotë e organizatave të specializuara të shoqërisë civile në procesin e mbetur hetimor, përfshirë dëgjimet e dëshmitarëve dhe analizimin e gjetjeve.
4. **T'i mundësohet RrGK-së akreditimi për monitorimin e punës së Komisionit**, në përputhje me procedurat dhe rregullat përkatëse të Kuvendit, me qëllim të përcjelljes së transparencës, gjithëpërfshirjes dhe zbatimit të mandatit të tij.

RrGK rithekson se qëllimi i kësaj kërkese nuk është të ndërhyjë në mandatin apo pavarësinë e Komisionit, por të vërë në dispozicion përvojën dhe ekspertizën e akumuluar ndër vite, në funksion të një hetimi sa më gjithëpërfshirës, profesional dhe të bazuar në dëshmi.

Vrasja e Arlinda Zekajt nuk duhet të mbetet vetëm objekt i një procedure parlamentare. Përgjegjësia e këtij Komisioni është që gjetjet e hetimit të përkthehen në masa konkrete dhe ndryshime institucionale që sigurojnë se gratë dhe fëmijët që kërkojnë ndihmë nga institucionet nuk do të mbesin më pa mbrojtjen që u takon.

Duke qenë se dëgjimet e dëshmitarëve pritet të fillojnë tashmë, kërkojmë që kjo kërkesë të shqyrtohet me urgjencë dhe RrGK-së t'i mundësohet përfshirja në procesin hetimor.

Me respekt,

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK)